

**AKT THEMELIMI  
i shoqërisë "BELLE EPOQUE" Sh.p.k.**

Sot, me datë 01 / 09/2021,

- **Z. Bruno Henri Robert Prince**, shtetas francez, lindur në Francë, më 23/02/1962, banues në Tiranë, mbajtës i Pashaportës me nr. 20AA57121, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Qj. Jeta Bardhi**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 06/05/1970, banuese në Tiranë, mbajtëse e Pashaportës me nr. BJ4047654 dhe me nr. personal. H055061470, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërите Третаре" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Pérgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "BELLE EPOQUE" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1  
EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "BELLE EPOQUE" Sh.p.k.

**NENI 2  
SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Perlat Rexhepi", Nr. Pasurie 4/194-N1/2, Zona Kadastrale 8270, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4  
OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Prodhim produktesh te pastiçerisë, émbëlsirave, brumrave, xhelaterisë (akullore). Tregtim dhe shërbim i tyre pranë selisë ose në ambientë të marra me qira për bar-pastiçeri. Import-Eksport artikuj ushqimore dhe lëndë e parë për pastiçeri. Bar-Kafe. Prodhim buke të të gjitha llojeve dhe shitjen e tyre me shumicë dhe pakicë.
- Gjithashtu në përputhje me legjisacionin shqiptar, mund të kryejë dhe realizojë çdo aktivitet, që lidhet direkt ose indirekt, që është pasojë e/apo e lidhur me aktivitetet e listuara më lart. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të ndërmarrë çdo aktivitet dhe shërbim qoftë tregtar, financiar, për dhënie e marrje me qira e hipotekim, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objekti i Shoqërisë. Shoqëria mund të ndërmarrë çdo veprimitari që është në përputhje me objektin e veprimitarisë së saj, i lidhur me të dhe në interes të saj. Shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri, sipërmarrje të përbashkëta, partneritete dhe të gjitha format e bashkëpunimit, brenda qëllimit dhe objekteve të saj. Shoqëria duhet të zbatojë të gjitha ligjet e rregulloret përkatëse dhe do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare. Ajo duhet t'i përbahet standardeve më të mira etike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 5.000.000 Lekë (pesë milion) dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Bruno Henri Robert Prince**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Zj. Jeta Bardhi**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Zj. Jeta Bardhi**, shtetase shqiptare, lindur më 06/05/1970, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e dokumentit Pashaportë me nr. B14047654 dhe me nr. personal. H055061470, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

## **NENI 7 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**


Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8 DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Zj. Jeta Bardhi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**BRUNO HENRI ROBERT PRINCE**



**JETA BARDHI**

